

HIGJIENA SH.A.

Nr. Fiskal	Nr. Fiskal
03/BORDI	323
Nr. Fiskal	Nr. Fiskal
01	16 05 2023
DEÇAN DEÇAN	



Add:Rruga UÇK
Qyteti: 51000-Deçan
Email:higjiena.de@gmail.com

Rregullore mbi Paradhënjet (Akontacionet) në

N.P.L "HIGJIENA" SH.A-Deçan

MAJ 2023

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike-Lokale, kodin e Etikës dhe Statutin e Kompanisë, për rregullim e dhënies dhe kthimit të paradhënieve (akontacioneve) të marrura nga punëtorët e Kompanisë N.P.L “HIGJIENA” SH. A nxjerr:

Rregullore mbi Paradhënjet (Akontacionet) në

N.P.L “HIGJIENA” SH.A-Decan

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është që gjithë punëtorëve të N.P.L “HIGJIENA” Sh.A, nga bugjeti i Kompanisë të ju mundësohet marrja e akontacionit, si dhe të përcaktohen procedurat e marrjes dhe kthimit të akontacionit.

Neni 2

Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Rregullore që me rregulla të mbrendshme të përcaktohen të gjitha pagesat me paradhënie (akontacione) që realizohen nga bugjeti i N.P.L “HIGJIENA” Sh.A, nga punëtorët për nevoja private si dhe zyrtare të Kompanisë.

Neni 3

Zbatueshmeria

- 1.Kjo rregullore është document zyrtar dhe i zbatueshëm i kompanisë. Si e tillë ajo është e zbatueshëm nga i gjithë personeli i saj që përfshihet në procesin e marrjes së akontacionit si dhe realizimit të procesit të dhënies së akontacionit.
- 2.Mosrespektimi i kësaj rregulloreje paraqet shkelje të rregullave të punës dhe rrjedhimisht sanksionohet me masa ndëshkimore konform procedurës disiplinore të kompanisë.
- 3.Për interpretimin e rregullave dhe procedurave të përcaktuara me këtë rregullore, si dhe për zgjidhjen e keqkuptimeve eventuale apo rasteve të veçanta duhet të kontaktohet zyrtari përgjegjës në shërbimin juridic të kompanisë.

Neni 4

Kushtet e përgjithshme në marrjen e akontacionit

1. Punëtorët gëzojnë të drejtën në paradhënie (akontacion) me destinacion të realizimit të nevojave në rast të:
 - 1.1. sëmundjes së punëtorit apo anëtarëve të familjes, me prezantimin e dokumentacioneve të jetë i vërtetuar nga spitali rajonal ose qendra kryesore e mjekësisë familjare.
 - 1.2. akontacioni si në pikën 1.1 i lejohet deri 50% e vlerës së të ardhurave neto pas tatimit, kontributit dhe ndalesave tjera në page.
2. Kërkesat tjera të punëtorëve për paradhënien (akontacion) të natyrës jo sin ë pikën 1 të kësaj Rregullore, realizohen deri 30% e vlerës së të ardhurave neto pas tatimit kontributit dhe ndalesave tjera në page.
3. Kërkesat e punëtorëve për paradhënie (akontacion) bëhen me shkrim nga ana e tyre dhe protokollohet në protokollin e Kompanisë.
4. Kërkesat i lejon Departamenti Financiar i Kompanisë.
5. Departamenti obligohet t'ja ndal në të ardhurat personale paradhënien (akontacion) dhe e njofton me shkrim kontabilitetin për ndalesën e kryer.
6. Departamenti financiar ndalesën e akontacionit për rastet si në pikën 1 të kësaj rregullore, obligohen ta realizoj, ta ndaloj në të ardhura personale të punëtorit në mënyrë proporcionale për tre muajt e ardhshëm, ndërsa rastet si në pikën 2 të rregullores punëtorit i ndalen në pagën e radhës.
7. Nëse shkëputet kontrata para kthimit në tërësi të shumës së dhënë të akontacionit, punëtorit në pagën e fundit i ndalet komplet pjesa të cilën e ka obligim për kthim. Mirëpo, nëse gjatë muajit në të cilën e ka shkëputur kontratën, ka punuar vetëm disa ditë të atij muaji, dhe shuma e pagës nuk arrin të mbulojë pjesën e asaj vlerë që duhet të kthehet nga punëtori, atëherë i jepet e drejta ndërmarrjes që të arkëtojë në forma tjera shumën e cila mbetet obligim i pambledhshëm pas shkëputjes së kontratës.
8. Punëtorit mund ti realizohet kërkesa për paradhënie (akontacion) i radhës pas pagesës definitive të akontacionit paraprak.

Neni 5

Dhënia e akontacionit për punëtorët në Portoarka (për nevoja zyrtare)

- 1.Punëtorëve të cilët punojnë në portoarkat e kompanisë i lejohet paradhënie (akontacion) në vlerë prej 100€ në muaj.
- 2.Akontacioni ju lejohet me date 30.01 të qdo viti.

Neni 6

Dhënia e akontacionit për Njësinë e furnizimit

- 1.Punëtorëve të cilët punojnë në Njësinë e Furnizimit i lejohet paradhënie (akontacion) në vlerë prej 1000€ në muaj.
- 2.Akontacioni ju lejohet me date 03.01 të qdo viti dhe të njëjtat të kthehen ose të barazohet me kontabilitetin deri me 31.12 të qdo viti.
- 3.Furnizuesit mund ti bëhet regjistrimi i jashtëzakonshme në qdo kohë të vitit.

Neni 7

Akontacionet për udhëtime zyrtare

- 1.Akontacionet për udhëtime zyrtare i lejohen punëtorëve vetëm në rastet kur ka një ftes zyrtare dhe i lejohet nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- 2.Shpenzimet për ushqim dhe fjetje ju lejohen sipas Vendimit të Ministrit të Financave me numër protokollit : 1214,date 20.06.2018.
- 3.Punëtorit mund ti lejohet paradhënia mbi vlerën e caktuar nga Ministria për ndonjë rast të jashtëzakonshëm, në të kundërtën vlera e marr e mjeteve nga Kompania mbi vlerën e lejuar duhet të kthehet.
- 4.Të ardhurat nga mëditjet do të tatimohen sipas pikes 1.2,të nenit 9, të Ligjit nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale.
- 5.Vlera maksimale e paradhënies (akontacionit) për punëtor të jetë 1000€.

Neni 8

Regjistrimi i paradhënieve

- 1.Për paradhëniet e dhëna Kontabiliteti obligohet që në Librin Kryesor të regjistroj në analitik paradhënien (akontacionin) dhe qdo ndales të cilën ja sjell Departamenti i Personelit ta zbres paradhënien (akontacionin).
- 2.Departmenti i Personelit dhe ai i Kontabilitetit obligohen të bëjnë kontrolle qdo fund muaj që të vërtetojnë ndalesën e të gjitha paradhënieve (akontacioneve) sipas kësaj rregullore.

Neni 9

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Datë: 16/05 / 2023

Deçan

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

z.Milazim Mushkolaj



SH.A.
HIGJIENA
DEÇAN

